



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 26.02.2025

Nr: 200

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV BAZUAR NË DENONCIMIN ME
NR. 10 ID, DATË 10.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE, TË
PARTISË DEMOKRATIKE**

Sot më datë 26.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim çështjen administrative me:

KËRKUES: Partia Demokratike

SUBJEKT: **Z. Agron Malaj**
Kryetar në Bashkinë Mat

Zj. Bora Muzhaqi

Ministër i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

OBJEKT: Konstatimi i kryerjes së veprimtarive të ndaluara, konkretisht promovimi i veprimtarive publike me karakter social, promovimi në rrjete sociale me profil zyrtar i investimeve të Bashkisë Mat dhe përdorimi i burimeve publike dhe njerëzore në mbështetje të subjekteve zgjedhore

BAZA LIGJORE: Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f”, “n” dhe pika 2, neni 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe neni 3, pika 3, e vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, të ndryshuar

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

Data: 26.02.2025 Nr: 200

Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ, bazuar në denoncimin me nr. 10 ID, datë 10.02.2025, të regjistrit të denoncimeve, të Partisë Demokratike

KONSTATOJ:

Partia Demokratike, nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, më datë 10.02.2025 ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 10 ID.

Në këtë denoncim Partia Demokratike parashtrohet sa vijon:

1. *“1. Bashkia Mat ka shpërndarë ushqime dhe ndihma për familjet në nevojë në qytetin e Matit”.*
2. *Kryetari i Bashkisë Mat, Agron Malaj në rrjetin e tij social Facebook ka shpërndarë dhe promovuar ngritjen e Qendrës Rinore Mat. Në rrjetin e tij social numërohen dhjetëra postime me sfond propagandistik duke promovuar punën e Bashkisë Mat.*
3. *Në ditën e promovimit të ngritjes së Qendrës Rinore Mat Kryetari i Bashkisë ka qenë i shoqëruar nga Ministria e Shtetit për Rininë dhe fëmijët, zj. Bora Muzhaqi.”*

Me vendimin nr. 97, datë 14.02.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ), u vendos fillimi i procedurës administrative, për shqyrtimin e këtij denoncimi. Bazuar në këtë vendim i`u kërkua personave përgjegjës në Bashkinë Mat dhe Ministrinë e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, që të paraqesin pretendimet në lidhje me çështjen objekt hetimi.

Më datë 13.02.2025, KQZ administroi pretendimet e Bashkisë Mat, dërguara me e-mail në KQZ.

Sipas këtyre pretendimeve:

“Ndryshe nga sa parashtrohet në mënyrë të gabuar subjekti politik “Partia Demokratike” vërtetohet se bashkia Mat nuk ka kryer apo promovuar veprimtari të ndaluar në kuptim të dispozitave ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, pasi ndihmat ushqimore nuk janë vënë në dispozicion me fonde të buxhetit të bashkisë Mat apo miratuar rishtazi në buxhet, por janë dhuruar nga subjekti/ shoqata “Qatar Charity”, ku dhe shpërndarja e tyre është nga vetë shoqata.

Bashkia Mat nuk ka kryer apo promovuar veprimtari të ndaluar në kuptim të dispozitave ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, pasi në rrjetin social të subjektit Agron Malaj, kryetar i bashkisë Mat janë kryer publikime për investime të filluara në vitin 2024 dhe më herët, si dhe janë publikuar punët e përditshme që kryhen me punonjësit e Agjencisë së Funksioneve të Transferuara, agjenci kjo nën varësinë e bashkisë Mat.

Gjithashtu bashkia Mat nuk ka përdorur/ vënë në dispozicion burime publike (asete apo njerëzore), pasi atë ditë ka qenë inaugurimi i “Qendrës Rinore Multifunksionale, Rekreative, Inovacion dhe Art” qendër kjo e bashkë financuar me fonde të Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe fëmijët dhe bashkisë Mat në vitin 2024 dhe nuk jemi përpara rastit që trajton dispozita e nenit 91, të Kodit Zgjedhor, atë të vënies në dispozicion të burimeve publike në mbështetje të kandidatëve, partive në fushata apo tubime elektorale.”

“Ngritja dhe inaugurimi i Qendrës Rinore në Bashkinë Mat është realizuar në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore për financimin e projekteve për njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe rregullave të legjislacionit zgjedhor për veprimtaritë publike të institucioneve publike në periudhën 4 (katër) muaj përpara datës së zgjedhjeve. Gjithashtu, aktiviteti publik i sipërcituar është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së në përputhje me parashikimin e pikës 2, të nenit 92, të Ligjit 10 019, datë 29.12.2008, Kodi Zgjedhor i ndryshuar, sipas të cilit “...Raportimi duhet të kryhet jo më vonë se pesë ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë...”. <https://aktivitete.kqz.gov.al/#/activities/reports>”

Më datë 18.02.2025, ora 12:00, u zhvillua seanca publike për këtë shqyrtim administrativ. Në këtë seancë u paraqitën përfaqësuesi i Bashkisë Mat, përfaqësuesi i Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe përfaqësuesi i Partisë Demokratike të cilët i qëndruan pretendimeve të depozituara me e-mail në KQZ.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi vlerësoi të gjitha pretendimet e palëve si dhe provat e administruara në dosjen e hetimit administrativ vlerësoi se:

Referuar denoncimit “*“1. Bashkia Mat ka shpërndarë ushqime dhe ndihma për familjet në nevojë në qytetin e Matit, duke nisur në këtë formë krimin zgjedhor”* neni 91, i Kodit Zgjedhor përcakton se institucionet publike nuk mund të përdorin ose të vendosin në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia. Aktiviteti i denoncuar nga Partia Demokratike është financuar, organizuar dhe kryer nga “Qatar Charity”, organizatë jofitimprurëse, provuar kjo nga kontrata e depozituar në cilësinë e provës dhe deklaratat e pjesëmarrësve në seancën dëgjimore.

Referuar denoncimit se, “*Kryetari i Bashkisë Mat, Agron Malaj në rrjetin e tij social Facebook ka shpërndarë dhe promovuar ngritjen e Qendrës Rinore Mat. Në rrjetin e tij social numërohen dhjetëra postime me sfond propagandistik duke promovuar punën e Bashkisë Mat. Në ditën e promovimit të ngritjes së Qendrës Rinore Mat Kryetari i Bashkisë ka qenë i shoqëruar nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe fëmijët, znj. Bora Muzhaqi”*, gjatë hetimit administrativ rezultoi e provuar se aktiviteti i organizuar nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët është raportuar pranë ndërfaqes së raportimeve në KQZ, në përputhje me parashikimet e nenit 92, të Kodit Zgjedhor dhe nenit 4, të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator, ku specifikohet se institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

Referuar nenit 3, pika 1, nënpika 1.1 të Vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator, ku përcaktohet se veprimtari të ndaluara për të promovuar janë veprimtaritë publike për të cilat janë vënë **rishtazi** apo **posacërisht** në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit

buxhetor të miratuar, **në periudhën 4 (katër) mujore** para datës së zgjedhjeve, rezultoi e provuar se fondet për ndërtimin e Qendrës Rinore në Bashkinë Mat nuk janë vendosur në dispozicion në periudhën e ndaluar nga vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator. Referuar vendimin nr. 566, datë 29.07.2022, të Këshillit të Ministrave “*Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave të përzgjedhjes së organizatave rinore dhe organizatave për të rinjtë, që përfitojnë financime nga fondet grant nga buxheti i shtetit, të dedikuara për rininë*”, e depozituara pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ndërtimi i kësaj qendre ka nisur që prej datës 04.03.2024, në kuadër të bashkëpunimit mes Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët me njësitë e qeverisjes vendore.

Për këto arsye, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se gjatë hetimit administrativ, nuk u arrit të provohej shkelja e nenit 91 dhe 92, të Kodit Zgjedhor dhe nenit 3, të Vendimit nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator dhe për këtë arsye duhet të pushohet hetimi administrativ për këtë denoncim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f”, “n” dhe pika 2, nenin 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 3 pika 3 e vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, të ndryshuar,

V E N D O S:

1. Pushimin e shqyrtimit administrativ të denoncimit nr. 10, datë 10.02.2025, ndaj:
 - Z. Agron Malaj, Kryetar i Bashkisë Mat;
 - Zj. Bora Muzhaqi, Ministër i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI